

NOTE INFORMUESE***Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit B.M.***

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur më datë 15.06.2020 verifikimin e fakteve të bëra publike nga media elektronike dhe ajo e shkruar gjatë transmetimit të lajmit për vrasjen në datën 11.06.2020 të shtetasit H.B., mbi gjendjen gjyqësore të këtij shtetasi me burgim të përjetshëm nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, si dhe njohja e këtyre vendimeve nga ana e autoriteve gjyqësore shqiptare. Pas verifikimit të të dhënave shtesë të administruara nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Krujë apo gjykatave të tjera lidhur me proceset gjyqësore të zhvilluara për rastet e paraqitura në media, më datë 16.07.2020, Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka urdhëruar fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë për magjistratin B.M, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për shkelje të rënda profesionale që diskretitojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës. Raporti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konstaton se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor B.M. ka patur:

- Mospërmbushje të pajustificuar të funksioneve gjatë dhe pas gjykimit dhe mosveprime e sjellje të magjistratit, që kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin.
- Mosrespektim i rëndë dhe i vazhduar i legjislacionit material dhe procedural penal.
- Veprime/mosveprime të kryera në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar në 4 procese gjyqësore. Qëndrimi i prokurorit në këto seanca ka qenë për praninë kërkesë apo lënien e tyre në çmim të gjykatës, duke mosushtruar ankim gjyqësor.
- Mosankimi i vendimeve gjyqësore nga ana e prokurorit ka passjellë pamundësinë e ushtrimit të kontrollit gjyqësor, të vendimeve të dhëna në kundërshtim me ligjin.
- Ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cenimin e prestigjit jo vetëm të gjykatës dhe humbjen e besimit ndaj tij, por dhe të prokurorisë, si përfaqësuese e interesit publik në gjykim, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- Këto standarde të gabuara mund të aplikohen edhe nga magjistratë të tjerë dhe mund të shërbejnë si praktikë për edhe shumë të dënuar të tjerë me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore të pretendojnë në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit penal në fuqi për lirin para kohe të tyre me kusht, përfitim amnistie, llogaritje kohe paraburgimi gjatë periudhës së qenies të dënuar, apo aplikimet alternative të dënimit pa marrë provat thelbësore në proces.

Për pasojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistratin B.M, të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1 shkronjat “ç”, “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.